



Prishtinë: 23.06.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1260_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2053_03_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **19.05.2020**.

në seancën e mbajtur më datë **23.06.2020**, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. Th. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR – 90060764 si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2053_03_20** i datës **16.03.2020**.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 19.05.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: konsumatori me vullnet të saj ka bërë pagesën e borxhit të KEK. Marrëveshja për inkasim mes KEK dh KESCO ka përfunduar në Maj 2018 dhe se aktualisht entitetet janë duke zhvilluar bisedime për nënshkrimin e marrëveshjes së re. Në ankesë KESCO ka theksuar se aktualisht nuk ka mundësi teknike dhe administrative si dhe bazë ligjore mbi shkarkimin e vlerës prej 1,621.64€. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2053_03_20 i datës 16.03.2020 për konsumatorin A. Th. me shifër DPR – 90060764.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se konsumatori me vullnet të saj ka bërë pagesën e borxhit të KEK, Bordi i ZRRE-së thekson se nuk është aspak relevante për gjendjen faktike të cilën DMK në ZRRE e ka konstatuar pas analizimit të shkresave të lëndës. Kjo për faktin se, përveç njehsorit elektrik nr.91032551, nga shkresat e lëndës rezulton se punëtorët e KEDS-it e kanë evidentuar edhe një njehsor tjetër elektrik nr.35258872 me gjendje TL=19046 kWh dhe TU=29126 kWh, dhe se nuk



është ofruar asnjë informacion ose provë nga i licencuari KEDS lidhur me këtë njehsor. Konsumatori ka mund të paguaj duke mos qenë në dijeni për shpenzimin që i është faturuar..

Bordi i ZRRE thekson se konsumatori në fjalë me datë 29.12.2016 ka parashtruar ankesë kundër faturës së muajit 05/2010 në vlerë prej 2,594.80€, dhe se KESCO e ka shqyrtuar dhe i ka dhënë konsumatorit përgjigjen me datë 27.01.2017, edhe pse arsyetimi ka qenë shumë i mangët dhe nuk i është përgjigjur saktë ankesës së konsumatorit lidhur me kundërshtimin e tij për faturën e muajit 05/2010, por që në mënyrë të përgjithësuar ka theksuar se komisioni nuk ka vërejtur asnjë element i cili mund të ketë shkaktuar ngarkesë financiare më shumë se sa që njehsori i konsumatorit ka regjistruar.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KESCO-s se Marrëveshja për inkasim mes KEK dh KESCO ka përfunduar në Maj 2018 dhe se aktualisht entitetet janë duke zhvilluar bisedime për nënshkrimin e marrëveshjes së re, Bordi i ZRRE thekson se kjo çështje nuk është objekt trajtimi në këtë ankesë dhe se për konsumatorin nuk është fare relevante. Marrëveshjet e tilla mes KEK dhe KESCO janë në mes të dy të licencuarve dhe se nuk ka të bëjë fare me konsumatorin.

Duhet theksuar se me datë 08.05.2013 Bordi i ZRRE ka bërë transferin e Licencës për Furnizim Publik me Energji Elektrike nga Korporata Energjetike e Kosovës SH.A ("KEK Sh.A") - Divizionit për Furnizim, në "Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A"- Divizioni i Furnizimit, me të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike. Pra me këtë potencojmë se me rastin e privatizimit të aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike kemi të bëjmë me transfer të licencës nga kompania publike KEK në kompaninë private KKDFE (atëkohë KKDFE dhe tani KEDS dhe KESCO pasi është bërë shturrja e kompanisë në dy entitete) me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KESCO-s se aktualisht nuk ka mundësi teknike dhe administrative si dhe bazë ligjore mbi shkarkimin e vlerës prej 1,621.64€, Bordi i ZRRE thekson se kjo çështje është në domenin e vet KESCO që t'i gjejë zgjidhje konsumatorit, pasi që sipas ZRRE konsumatori në fjalë nuk është dashur të faturohet me faturën nr.051086431DPR-90060764 e datës 03.06.2010 në vlerë prej 2,594.80€ dhe kjo me njehsorin elektrik nr.35258872 sepse KESCO nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me faturën e kundërshtuar nga konsumatori 05/2010 si dhe nuk ka dhenë sqarim se bazuar në cilin dokument është vërtetuar shpenzimi i energjisë elektrike i njehsorit elektrik nr.35258872 prej TL=19046 kWh dhe TU=29126 kWh. Pra, siç edhe është sqaruar në paragrafin e parë, tek i njëjti konsumator ka ekzistuar edhe një njehsor elektrik tjetër, dhe se KEDS/KESCO nuk ka ofruar asnjë sqarim ose provë lidhur me këtë të gjetur, e që rrjedhimisht i bie se, konsumatori është faturuar padrejtësisht për shpenzim të energjisë elektrike për një njehsor që madje as nuk e ka ditur që ekziston.

Duhet theksuar se KESCO në kundërshtimin e tij ndaj vendimit të DMK për konsumatorin në fjalë nuk ka kundërshtuar esencën e lëndës e cila ka të bëjë me të drejtën e faturimit të faturës nr.051086431DPR-90060764 të datës 03.06.2010 në vlerë prej 2,594.80€, por vetëm ka kundërshtuar se KEK dhe KESCO nuk kanë për momentin marrëveshje të inkasimit pasi që e njëjta ka skaduar në Maj 2018.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A.Th dhe
- Arkivit të ZRRE-së.